



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr. 59, Datë 05.06.2020

Mbështetur nenin 32, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nisur nga ngjarja e ndodhur në datën 04.02.2020 në Teatrin ArTurbina, ku drejtori i këtij teatri, z. K. L. ndërpreu shfaqjen teatrale “Sfida”, ideuar, skenuar dhe aktruar nga persona me aftësi të kufizuara, duke përdorur ndaj tyre e familjarëve të tyre, fjalor fyes në prani të stafit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të vetë këtij të fundit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat për shqyrtimin kryesisht të kësaj çështjeje.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Sipas informacionit të administruar, rezulton që në pasditen e datës 04.02.2020, pranë Teatrit ArTurbina u zhvillua shfaqja Teatrale “Sfida”, ku aktorë ishin persona me aftësi të kufizuara dhe jo të tillë. Për zhvillimin e kësaj shfaqjeje, e cila u organizua nga një sërë aktorësh², ishte marrë paraprakisht leja përkatëse nga Ministria e Kulturës. Shfaqja ishte një ndër aktivitetet e parashikuara për t’u zhvilluar në kuadër të “*Javës Kundër Diskriminimit*”, me rastin e 10-vjetorit të krijimit dhe funksionimit të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

² Shfaqja teatrale u organizua nga një sërë aktorësh, ku përfshihen Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ADRF, Caritas Shqiptar, Caritas Dioqezan Tiranë Durrës, Klubi i prindërve të fëmijëve me çregullime të Spektrit Autik, Kolegjit Don Bosko, përfaqësues të komunitetit të personave që nuk shikojnë dhe Ministria e Kulturës.

Sipas planifikimit përkatës, ora e përfundimit të shfaqjes ishte ora 18:00. Pikërisht në këtë orë, z. K. L., Drejtor i teatrit ArTurbina u paraqit pranë derës së sallës, ku zhvillohej shfaqja teatrale, e cila ishte në përfundim e sipër. Ai kërkoi me zë të lartë, që të pranishmit në sallë të dilnin jashtë, se orari i shfaqjes kishte përfunduar, si dhe kërcënoi për mbylljen e dritave të sallës, duke përdorur fjalor fytes ndaj personave me aftësi të kufizuara e duke i cilësuar ata “të metë”.

Në kushtet kur, një pjesë e spektatorëve dhe aktorëve në sallë ishin persona me aftësi të kufizuara, ku shumë prej tyre ishin të verbër apo individë, që lëviznin me karrocë me rrota, organizatorët e shfaqjes kërkuan disa minuta kohë shtesë, që këta persona të dilnin nga salla. Në kundërpërgjigje, drejtori i këtij teatri u soll në mënyrë jo institucionale dhe në mungesë të çdo etike me ta.

Organizatorët e shfaqjes theksojnë faktin se fryma aspak bashkëpunuese e stafit të këtij teatri, ishte vënë re edhe në ditët para zhvillimit të shfaqjes. Aktorëve dhe stafit organizator nuk iu vunë në dispozicion punëtorët e skenës, si dhe nuk u lejuan të zhvillonin qetësisht provat përfundimtare.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të fakteve të administruara, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj ex-officio nëpërmjet Urdhërit nr.30, datë 24.02.2020.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 329/1, datë 24.02.2020, z. K. L., Drejtor i Teatrit ArTurbina dhe për dijeni Ministres së Kulturës dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku kërkohet informacion mbi ngjarjen e ndodhur në datën 04.02.2020.
- 1.** Z. K. L., Drejtor i Teatrit ArTurbina nuk iu përgjigj shkresës nr. 329/1, datë 24.02.2020, së Komisionerit.
- 2.** Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish Z. K. L., Drejtor i Teatrit ArTurbina nëpërmjet shkresës nr.329/2, datë 15.04.2020, ku i bën kujtesë për kthim përgjigje.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

3. Zarfi me shkresën e KMD-së u kthye mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “objekt i pakërkuar”.

4. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes ex-officio, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në pasditen e datës 04.02.2020, pranë Teatrit ArTurbina u zhvillua shfaqja Teatrale “Sfida”, e cila ishte një ndër aktivitetet e zhvilluara në kuadër të “*Javës Kundër Diskriminimit*”, me rastin e 10-vjetorit të krijimit dhe funksionimit të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Shfaqja teatrale u organizua nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me ADRF, Caritas Shqiptar, Caritas Dioqezan Tiranë Durrës, Klubi i Prindërve të Fëmijëve me Çregullime të Spektrit Autik, Kolegjit Don Bosko, përfaqësues të komunitetit të personave që nuk shikojnë dhe Ministria e Kulturës.

Nëpërmjet shkresës nr. 160, datë 27.01.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kishte kërkuar lejen përkatëse nga Ministria e Kulturës për zhvillimin e kësaj shfaqjeje dhe ky institucion, i cili ishte një ndër organizatorët e këtij eventit ka dhënë lejen përkatëse.

Shfaqja e sipërpërmendur kishte si aktorë persona me aftësi të kufizuara dhe jo të tillë. Ky ishte një event i shumëpritur nga aktorët me aftësi të kufizuar dhe jo vetëm, të cilët kishin investuar shumë punë, përkushtim, kohë, dëshirë dhe vullnet të mirë për ta përballuar me sukses këtë sfidë. Të afërmit e tyre dhe shumë spektatorë të tjerë prisnin me padurim të shihnin rezultatet e punës së tyre.

Të gjithë aktorët, spektatorët, titullarë dhe përfaqësues të intitucioneve të ndryshme që po ndiqnin këtë shfaqje asistuan dhe u bënë dëshmitarë të sjelljes arrogante, fjalëve fyese dhe reagimit aspak të përshtatshëm të z. K. L., Drejtor i Teatrit ArTurbina, në ambientet e sallës, ku po zhvillohej shfaqja, e cila ishte në minutat e fundit të saj.

Ai kërkoi me zë të lartë, që të pranishmit në sallë të dilnin jashtë, se orari i shfaqjes kishte përfunduar, si dhe kërcënoi për mbylljen e dritave të sallës, duke përdorur fjalor fyese ndaj personave me aftësi të kufizuar e duke i cilësuar ata “të metë”.

Në kushtet kur, një pjesë e mirë e spektatorëve dhe aktorëve në sallën e Teatrit ArTurbina ishin persona me aftësi të kufizuar, ku shumë prej tyre ishin të verbër apo individë, që lëviznin me karrocë me rrota, organizatorët e shfaqjes kërkuan disa minuta kohë shtesë, që këta persona të

dilnin nga salla. Në kundërpërgjigje, drejtori i këtij teatri u soll në mënyrë aspak institucionale dhe në mungesë të çdo etike me ta.

Për sa më sipër, dëshmitarë të kësaj ngjarjeje ishin të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet, të cilët mbetën tepër të indinjuar nga sjellja e z. K. L. Por, ata që u ndienë më të indinjuar dhe mbi të gjitha të keqtrajtuar dhe të shqetësuar nga kjo sjellje dhe nga fjalët fyese të tij, ishin aktorët me aftësi të kufizuar, prindërit e të afërmit e tyre që ndiqnin shfaqjen teatrale, si dhe spektatorët e tjerë me aftësi të kufizuar, të cilët asistuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimet e Drejtorit të këtij teatri.

Për sa më sipër, në kuptim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. Nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i cili parashikon: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*, Komisioneri gjykon se sjellja dhe fjalët e Drejtorit të Teatrit ArTurbina i kanë ekspozuar të gjithë individët me aftësi të kufizuar, që merrnin pjesë në shfaqje në rolin e aktorit, organizatorit apo spektatorit, ndaj një qendrimi të padrejtë, shqetësues dhe disfavorizues.

A. Shkaku i mbrojtur.

Në këtë çështje ex-officio, Komisioneri po shqyrton ngjarjen e ndodhur në datën 04.02.2020, pranë Teatrit ArTurbina, ku u zhvillua shfaqja Teatrale “Sfida”, në fund të së cilës z. K. L., Drejtor i këtij teatri, u soll në mënyrë të pavend duke përdorur fjalë fyese, denigruese dhe përçmuese ndaj pjesëmarrësve dhe aktorëve me aftësi të kufizuar.

1. *“Aftësia e kufizuar”* është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, Komisioneri gjykon se, ky shkak është i mbrojtur ligjërisht, pasi parashikohet si i tillë nga ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, si dhe të gjithë personat e sipërpërmendur e mbartin këtë shkak.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për sa më sipër, legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar i ofrojnë mbrojtje të posaçme nga diskriminimi individëve me aftësi të kufizuar.

Neni 1⁴, i Protokollit 12, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara më ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) i autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njeh individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar siguron një mbrojtje të posaçme të këtyre individëve ndaj çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie, ndaj së cilës ata mund ekspozohen nga ana e institucioneve shtetërore apo subjekteve private. Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërveprim me barrierat të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë. Neni 4 i kësaj Konvente parashikon detyre specifike për mbrojtjen e të drejtave të individëve me aftësi të kufizuar të tilla si:

“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin përsipër: (a) Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë; (b) Të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative për të modifikuar apo shfuqizuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikën ekzistuese, të cilat kanë përmbajtje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar; (c) Të marrin parasysh mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha politikën dhe programet; (d) Të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë Konventë dhe të sigurohen që autoritetet dhe institucionet

⁴ Neni 1, protokollit 12 i KEDNJ parashikon shprehimisht: “1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

publike veprojnë në përputhje me këtë Konventë; (e) Të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar nga personat, organizatat apo ndërmarrjet private; etj.”

Ndërkohë që neni 5, i saj përcakton se Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në çdo rrethanë.

Përveç sa më sipër, në kontekst të interpretimit të bërë nga ana e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shtetet palë të kësaj konvente marrin përsipër detyrime të rëndësishme në lidhje me mosdiskriminimin dhe ruajtjen e barazisë së personave me aftësi të kufizuara.

Në pikën II/1, të Komentit të Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, të Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (miratuar në Sesionin e 19 (14 Shkurt – 9 mars 2018), të këtij Komiteti) citohet: *“Barazia dhe mosdiskriminimi janë ndër parimet dhe të drejtat më themelore të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Për shkak se ato janë të ndërlidhura me dinjitetin njerëzor, ato janë gur themeli i të gjitha të drejtave të njeriut. Në nenet 1 dhe 2 të saj, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut shpall se të gjithë janë të barabartë në dinjitet dhe të drejta, dhe dënon diskriminimin në një numër jo-shterues të bazave.”.*

Në pikën VIII/c të këtij Komenti, shteteve palë u kërkohet shprehimisht, që legjislacioni i mosdiskriminimit të shtrihet në sferat private dhe publike, si dhe të mbulojë fushat përfshirë arsimin, punësimin, të mirat dhe shërbimet për mbrojtjen nga diskriminimi të individëve me aftësi të kufizuar.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet edhe Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996) që ndalon diskriminimin për një liste joshteruese shkaqesh. Neni E, në Pjesën V të kësaj Karte parashikon shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”⁵.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të*

⁵ Aftësia e kufizuar përfshihet në opsionin “statusi tjetër”

ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Për sa më sipër, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”(LMD) siguron të drejtën e çdo individi për t’u mbrojtur nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për të gjitha shkaqet e përcaktuara në nenin 1, të këtij ligji. Në nenin 20, të LMD, parashikohet shprehimisht: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose mecilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (LMD) në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjithashtu, neni 3, pika 5 e LMD, parashikon shprehimisht: *““Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.”*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se veprimet e z. K.L.përkojnë me parashikimin e neni 3, pika 5, të ligjit të sipërpërmendur. Në rastin konkret, veprimet e z. K.L.kanë sjellë shqetësim, kanë krijuar një mjedis poshtërues e ofendues, si dhe kanë shkelur dinjitetin, e dy kategorive individësh, në shfaqjen teatrale, të zhvilluar në datën 04.02.2020, në Teatrin ArTurbina. Kategoria e parë, së cilës i është shkelur dinjiteti dhe i është krijuar shqetësim nëpërmjet sjelljes dhe fjalëve të z. Londo, është ajo e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, që ndodheshin në sallën teatrale të Teatrit ArTurbina, ku bëjnë pjesë jo vetëm ata individë që performonin në shfaqje, por edhe ata që ishin në rolin e spektatorit apo organizatorit të kësaj shfaqjeje.

Kategoria e dytë e individëve, të cilët janë ekspozuar ndaj shqetësimit dhe poshtërimit nga ana e sjelljes dhe fjalëve së z. Londo, përbëhet nga të gjithë ata individë që ishin prindër dhe të afërm të personave me aftësi të kufizuara, që aktronin në shfaqje.

Për sa më sipër, në çështjen S. Coleman v. Attridge Law dhe Steve Law (2008)⁶, Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka vendosur që ndalimi i shqetësimit nuk është i kufizuar vetëm tek një person që posedon karakteristika të caktuara, sikurse është aftësia e kufizuar. Mbrojtja ligjore shtrihet edhe më tej tek të afërmit e tij. Sipas vendimit të GJED-së edhe nëna e një fëmije me aftësi të kufizuara është e mbrojtur gjithashtu ligjërisht nga legjislacioni i Bashkimit Europian. Në referencë të këtij vendimi nëna e fëmijës me aftësi të kufizuar është diskriminuar, në formën e shoqërimit.

Shqetësimi në vetvete është i gabuar për shkak të formës që merr në trajtën e abuzimit verbal, jo-verbal ose fizik dhe efektit të mundshëm, që mund të ketë, duke shkelur dinjitetin njerëzor. Një fakt i tillë u konstatuar edhe në fund të shfaqjes teatrale “Sfida”, ku sjellja dhe fjalët e z. K.L.patën një impakt tepër negativ tek të gjithë individët pjesëmarrës në këtë event, por sidomos tek personat me aftësi të kufizuar dhe të afërmit e tyre.

Kodi i Procedurës Administrative⁷, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast z. K.L., Drejtor i Teatrit ArTurbina, që duhet të provojë se individët me aftësi të kufizuar, pjesëmarrës në event nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS⁸ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër së cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër së cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër së cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

⁶ European Court Reports 2008 I-05603, Case C-303/06.

⁷ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

⁸ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që, megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.⁹

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të administruara, që dolën nga procedura e shqyrtimit të çështjes ex-officio, Komisioneri gjykon se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i individëve me aftësi të kufizuar, pjesëmarrës në shfaqjen teatrale “Sfida”, që u zhvillua në datën 04.02.2020, në këtë teatër, si pasojë e sjelljes aspak të përshtatshme, në adresë të tyre, nga ana e z. K.L., Drejtor i Teatrit ArTurbina.

Dëshmitarë të kësaj sjelljeje dhe fjalëve fyese ishin të gjithë pjesëmarrësit në shfaqjen teatrale, ndërkohë që z. K.L. nuk i ka kthyer përgjigje shkresave të Komisionerit, duke mos dhënë asnjë justifikim për sjelljen dhe veprimet e tij. Komisioneri vlerëson se Drejtori i Teatrit ArTurbina nuk vërtetoi asnjë nga dy momentet e mëposhtme:

1. Nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar, që është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të padrejtë e disfavorshëm nga ana e tij, të konstatuara edhe nga Komisioneri në këtë vendim ose,
2. Veprimet e tij kundrejt individëve me aftësi të kufizuar, pjesëmarrës në shfaqje, kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në referencë të parashikimit të nenit 7, pika 1 të LMD, Komisioneri gjykon se të gjithë individët me aftësi të kufizuar, që morën pjesë në cilësinë e aktorëve, spektatorëve apo organizatorëve të këtij eventi, janë diskriminuar në formën e shqetësimit, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e z. K.L., Drejtor i Teatrit ArTurbina. Komisioneri gjykon gjithashtu se prindërit dhe të afërmit e tyre janë diskriminuar në formën e shoqërimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e z. Londo.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 3, pika 5, nenin 7, pika 1, nenin 20, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit, *në formën e shqetësimit*, për shkak të aftësisë së kufizuar, të të gjithë personave me aftësi të kufizuar, që morën pjesë në cilësinë e aktorëve, spektatorëve apo organizatorëve, të shfaqjes Teatrale “Sfida”, që u zhvillua në datën 04.02.2020, në Teatrin ArTurbina, nga z. K. L., Drejtor i këtij teatri.
2. Konstatimin e diskriminimit, *në formën e shoqërimit*, për shkak të aftësisë së kufizuar, të prindërve dhe të afërmeve të personave me aftësi të kufizuar, të përmendur në pikën 1 të Vendimit, që morën pjesë në rolin e spektatorëve në shfaqjen Teatrale “Sfida”, që u zhvillua në datën 04.02.2020 në Teatrin ArTurbina, nga z. K. L., Drejtor i këtij teatri.
3. Në referencë të pikave 1 dhe 2, të këtij Vendimi, z. K. L. duhet të kërkojë falje publike ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuar.
4. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të vihet në dispozicion të personave me aftësi të kufizuar, një nga sallat e Teatrit ArTurbina, për një shfaqje teatrale.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, z. K. L., Drejtor i Teatrit ArTurbina, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij Vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – sherbime
Shkak – aftësi e kufizuar